



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranimar / Dorezuar Prijmljeno/Prodato Received/Delivery	22.05.2023	3	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Bri Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKINYSHEK	4366/2023		113



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.686/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Malsore Gashi Bajraktari-anëtarë, me Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.686/2023 të datës 28.04.2023 të parashtruar nga ankuesja kundër organit të punësimit Agjencia e Regjistrimit Civil, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datë 19.05.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa A.nr.686/2023 e datës 28.04.2023, e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja (tuje vetëm ankuesja), e punësuar në Agjencinë e Regjistrimit Civil, më datë 28.04.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit Nr.341 të datës 31.03.2023 të Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Regjistrimit Civil, për shkak të shkeljeve të dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtaret Publikë, Ligjit të ARC-së dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plot të gjendjes faktike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në testin e metejmë Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 05.12.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankueses të Agjencia për Regjistrimit Civil, ndërsa kjo e fundit më datë 16.05.2023 ka përcjell përgjigjen në ankesë si dhe shkresat lidhur me çështjen në procedurë të shqyrtimit dhe vendosjes.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoli 3909/2022 të datës 28.04.2023 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ndryshimin e Aktit të Emërimit i datës 01.12.2015; Vendimi me Nr.341 i datës 31.03.2023 për caktimin e Zëvendësueses të Udhëheqësit të Sektorit për Mbështetje

të QPD-ve; Kërkesa për përgjigje në ankesë përmes e-malit zyrtar të datës 04.05.2023; Përgjigje në ankesë e datës 16.05.2023 nga organi i punësimit bashkë me shkresat e lëndës; Akt emërimi me nr.ref.DRGJC/ARC-6/13 i datës 31.01.2013 për ankuesen; Akt emërimi me nr.ref.ARC-02/18 i datës 17.01.2018 për ankuesen; Ndryshimi i Aktit të Emërimit me nr.3932 i datës 24.05.2019; E-mailin zyrtar i datës 29.03.2023–kërkesë dhe Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Udhëheqës i Sektorit të Mbështetjes së Qendrave për Pajisje me Dokumente e datës 15.05.2015.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës konstatoi se ankesa e ankueses **është e palejuar, sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës është konstatuar fakti së ankuesja është e punësuar në Agjencinë e Regjistrimit Civil, dhe së e njëjta ushtron pozitën e punës Zyrtare e lartë për letërnjoftime në Sektorin për Letërnjoftime.

Me tej nga shkresat e lëndës Kolegji ka gjetur së Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Regjistrimit Civil përmes Vendimit Nr.341 të datës 31.03.2023, nëpunësen civile me inicialet në pozitën e punës Zyrtare për Rishqyrtimit e Aplikacioneve për Patentë Shoferë në Sektorin për Patentë Shofer, e ka caktuar Zëvendësuese e Udhëheqësit të Sektorit për Mbështetje të QPD deri në marrjen e një vendimi tjetër. Ankuesja kundër këtij vendimi ka parashtruar ankesë në Këshill, duke pretenduar së i njëjti është nxjerr në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Ligjit Nr. 04/L-160 për Agjencinë e Regjistrimit Civil.

Në vështrim të dispozitave ligjore të nenit 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, konstatohet së çdo nëpunës civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHCK për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e punës. Andaj, nisur nga ky përcaktim ligjor si dhe duke i'u referuar dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative përkatësisht nenit 14 me të cilin është përcaktuar se kush konsiderohet palë në procedure: "1. Palë në procedurën administrative mund të jetë çdo person fizik, person juridik apo grup personash me një interes të përbashkët: 1.1. me kërkesë të të cilit organi publik ka filluar procedura administrative; 1.2. ndaj të cilit ka filluar procedura administrative apo të cilit rezultati i procedurës administrative mund t'i cenojë të drejtat apo interesat juridike. 2. Palë në procedurën administrative janë, gjithashtu, dhe mbrojtësit e interesave publike të autorizuar me ligj të veçantë, si dhe mbrojtësit e interesave kolektive apo të interesave të gjera të publikut, nëse këto interesa mund të cenohen nga rezultati i procedurës administrative", si dhe nenit 124 paragrafi 1 të të njëjtit ligj me të cilin parashihet se: *Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim...*, Kolegji i Këshillit konstaton së me Vendimin e kundërshtuar më ankesë nuk është cenuar ndonjë e drejtë apo interes juridik i ankueses ndërlidhur me marrëdhënien e saj të punës, gjegjësisht vendimi i referohet caktimit të përkohshëm të zëvendësues se Udhëheqësit të Sektorit për Mbështetje të QPD në Agjencinë e Regjistrimit Civil, kështu që, bazuar në këtë konstatim si dhe në mbështetje të nenit 129 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, rrjedhë së ankesa e ankuesit është e palejuar dhe se ankuesi nuk ka legjitimitetin e palas në këtë çështje juridiko-administrative.

Siç u tha me sipër, Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda më numër A.nr.686/2023

Sabile Avdyli
Sabile Avdyli
Procesmbajtëse

Ardita Haxhika-Demi
Ardita Haxhika-Demi
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

